

---

**AKT THEMELIMI**  
**i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**  
**“Vlora Security” SH.P.K.**

Sot, me 13.10.2021, une i nenshkruari: Llazar Metaj i datelindjes 23.04.1980 i pajisur me karten e identitetit I00423089K, themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“Vlora Security” Sh.p.k.**,

**Neni 1**

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“Vlora Security” Sh.p.k.**, me kapital themeltar 100 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Njesia Bashkiake Nr. 11, Rruga Koco Stralla, Ndertesa nr. 5, Kati 5.

Ortaku i kesaj shoqerie do te jete : Llazar Metaj.

Shoqeria **“Vlora Security” Sh.p.k.**, ka te drejte te krijoj filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menyrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

**Neni 3**

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithë ortaket e saj.

#### Neni 4

Objekti i shoqerise : Sigurimi i objekteve publike e private ne pronesi ose ne perdorim te personave fizike dhe juridike qe ushtrojne veprimtari ne territorin e Republikes se Shqiperise. Sigurimi dhe mbrojtja e jetes dhe shendetit te personave fizike, shtetas te huaj ose shqiptare. Tregtimi i armeve te gjahut dhe materialeve te tjera te gjuetise. Pastrim dhe administrim godina/ambjente banimi apo zyresh. Projektim, zbatim, shitje, mirembajtje, dhe instalim sistemesh elektronike te sigurise dhe te mbrojtjes pasive si ato te alarmit, video vezhgimit dhe akses kontrollit. Import - Eksport i mallrave industriale dhe ndertimore. Trajnime ne fushen e sigurise dhe kujdesit ne pune. Trajnime ne fushen e sigurise fizike dhe taktikave te mbledhjes se informacionit dhe ato luftarake. Import -Eksport - Ndermjetesim per mallra te industrise ushtarake. Projektim, instalim rrjete kompjuterike. Importi - eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshje te te gjitha llojeve. Shitja me shumice dhe pakice e mallrave industrial dhe ushqimore. Tregtimi i artikujve te ndryshem. Importi - eksporti shitja me shumice e pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te para per industrine, materiale ndertimi dhe hidrosanitare, pajisje zyresh kancelari, pjese kembimi, auto dhe makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Shitja, blerja dhenia me qira e pasurive te paluajtshme. Transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit. Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve dhe restoranteve. Ofrimi i sherbimit te konsulences, ne fushen e biznesit, manaxhimit, taksave etj. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqerim i vlerave monetare apo dhe sendeve te çmuara gjate transportit te tyre. Kryerjen e çdo aktiviteti si shoqeri e ruajtjes dhe sigurise fizike SHPSF kategoria 1.3. B ne perputhje me ligjin Nr. 75/2014. Import eksport, tregtimi i artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice e pakice. Sisteme alarmi, vezhgimi GPS, si dhe te gjitha pajisjet ndihmese, fdm rezistent kundra shperthimeve, thyerjeve dhe demtimeve. Import, eksport, mbajtje, ruajtje, prodhim, tregtim, gjurmim dhe transport brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise te armeve dhe municioneve te parashikuara ne ligj, te mallrave ushtarake me nje perdorim dhe mallrave te teknologjise me perdorim te dyfishte. Çaktivizim dhe riparim te annexe. Tregtim te armeve te gjahut dhe materialeve te tjera qe lidhen me gjuetine si dhe çertifikime ne fushen e gjuetise, ushtrimi i veprimtarise se qitjes sportive sipas ligjeve ne fuqi. Qender formimi profesional teorik/praktik per personat qe ligji u lejon te mbajne arme. Qender formimi profesional teorik/praktik, per sherbimin privat te sigurise fizike, ne fushen e sigurise. Organizim i panairave te artikujve ushtarake me nje perdorim dhe atyre me perdorim te dyfishte, organizim i ekspozitave kombetare dhe nderkombetare brenda dhe jashte vendit si dhe organizim i konferencave kombetare dhe nderkombetare brenda dhe jashte vendit. Qender formimi profesional dhe poligon civil qitjeje te ndertuar per qellime rekreative, sportive dhe te praktikues me shenjester, te miratuar dhe te çertifikuar sipas ligjeve ne fuqi, si dhe cdo aktivitet tjetër ndihmes per te permbushur dhe realizuar objektin si me siper ne perputhje me ligjin 75/2014. Liçenca per import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D". Liçenca për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive "B1" , B4", "C" dhe "D". Neni 17 Liçenca për poligon civil qitjeje. Neni 18 Liçenca për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën. Konsulence dhe implementim te sistemeve te telekomunikacionit. Projektim i sistemeve elektronike dhe te telekomunikacionit. Ndjekje dhe kontroll i realizimit te projekteve. Import-eksport, projektim, instalim dhe mirembajtje per: Pajisje dhe sisteme elektronike, pajisje, rrjete dhe sisteme te telekomunikacionit, pajisje software, sisteme dhe rrjete te teknologjise se informacionit, pajisje dhe sisteme te dedektimit dhe mbrojtjes nga zjarri, pajisje dhe sisteme te vezhgimit, mbikqyrjes dhe alarmit, pajisje dhe sisteme elektrike, energjetike dhe te burimeve te ushqimit. Shoqeria mund

te realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj brenga limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Ofrimi i rrjeteve dhe sherbimeve te komunikimeve elektronike. Ofrimit te Sigurise se Aviacionit Civil dhe dhenien e trajtimeve ne fushen e sigurise se Aviacionit Civil.

Gjithashtu shoqëria mund te ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

#### **Neni 5**

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 000 lekete ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000 leke per kuote ku:

Llazar Metaj zoteron kete kuote me vlere 100 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga aksionaret ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimet te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Biznesit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.

#### **Neni 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

#### **Neni 7**

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

#### **Neni 8**

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

#### **Neni 9**

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.


**Neni 10**

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

**Emri dhe nenshkrimi i Ortakut Themelues:**

**LLAZAR METAJ**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Llazar Metaj', written over the printed name.